

# OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

## 2 TETOR-NËNTOR 2020

## Përmbledhje e pikave kryesore



### Rrjeti i kapur shqiptar i kokainës drejtohet nga burgu në Ekuador

Më 17 shtator, Europol ka lëshuar informacionin për një operacion të madh ndërkombëtar që ka shkatërruar një nga rrjetet më aktive shqip-folëse të tregtisë të kokainës në Europë. Mediat shqiptare spekulojnë se drejtuesi është një kriminel famëkeq shqiptar i moshës 40 vjeçare. Interesant është fakti që ai ka qënë i burgosur në Ekuador për gjashtë vitet e fundit. Ky rast tregon zhvillimin e grupeve kriminale nga Ballkani Perëndimor, dhe dobësinë e sistemeve të drejtësisë në Amerikën Latine, që mundësojnë që kriminelët e Ballkanit të operojnë atje – madje nga burgu.



### Armët e kundërligjshme në Ballkanin Perëndimor: një kërcënim për Europën

Evropa Juglindore është mbushur me armë, veçanërisht nga trashëgimia e luftërave në ish Jugosllavi. Disa shtete në rajon ende prodhojnë armë. Ka një shqetësim në Europën Perëndimore se pistoletat, granatat dhe eksplozivët nga Evropa Juglindore përdoren në dhunën e bandave dhe nga ekstremistët dhe terroristët. Ky artikull

analizon qëllimin dhe natyrën e kërcënimit, si dhe përpjekjet për ta adresuar atë përmes Procesit të Berlinit.



### Krimi i organizuar përmes këndvështrimit gjinor

Krimi i organizuar zakonisht konsiderohet si botë e burrave. Ka pak informacion për rolin e grave si viktime apo autore të krimit. Kjo çështje ka marrë pak vëmendje në Ballkanin Perëndimor dhe megjithatë ka lidhje të qarta ndërmjet krimit dhe meshkujve në rajon. Ky artikull sheh në krimin e organizuar në Ballkanin Perëndimor përmes këndvështrimit gjinor gjinore për të kuptuar më mirë rregullat jo formale të cilat fomësojnë rolet e ndryshme për burrat dhe gratë, dhe për të theksuar se çfarë mund të bëhet për të hartuar kundërmasat për të ndryshuar qëndrimet, imazhet dhe sjelljet.



### Fishingu në Maqedoninë e Veriut

Hakerët në Maqedoninë e Veriut kanë zhvilluar një reputacion famëkeq, nga prodhimi i lajmeve të rreme gjatë zgjedhjeve të fundit në SHBA deri te kryerja e një numri joproportional të krimeve kibernetike. Kohët e fundit, krimet kibernetike duket se kanë një ndikim të



rritur në sektorin privat në Maqedoninë e Veriut, sidomos si rezultat i teknikës të njohur si “fishing” që përdoret për të vjedhur të dhënat apo për të kryer një mashtrim. Ky artikull sqaron se si funksionon fishing dhe ndikimi i tij.



### **Krijimi i vizionit të përbashkët, dhe të 'papakshmit': Rrjeti Ballkanik i Kriminologjisë**

Në fokusin tonë muajor mbi rezistencën, Dr Anna-Maria Getos Kalac, themeluese dhe bashkë-udhëheqëse e

Kriminologjisë Ballkanike dhe profesore e asociuar në Universitetin e Zagrebit, në Fakultetin e Drejtësisë, flet për ndarjen e silove ndërmjet akademikëve, shoqërisë civile, mediave dhe praktikantëve të drejtësisë penale në Ballkanin Perëndimor, si dhe kërcënimin që paraqitet nga 'të paprekshmit' dhe roli i akademisë në luftimin e korrupsionit.

## **RRETH CESHTJES**

Faleminderit për reagimet tuaja pozitive në Çështjen 1 të Buletinit të Rrezikut i përgatitur nga Observatori i Shoqërisë Civile për të Luftuar Krimin e Organizuar në Evropën Juglindore. Vlerësojmë komentet tuaja dhe mirëpresim sugjerime për mbulime historish dhe temash.

Në këtë botim ne shohim një rast të vonshëm që është paraqitur në lidhje me rrjetin shqip-folës të tregtisë të kokainës që vepronte jashtë Ekuadorit. Kjo ilustron një tendencë që Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Transnacional (GI-TOC) ka nënvizuar në raportin e korrikut të vitit, 'Tentakulat transnacionale: Pikat e nxehta globale të krimin të organizuar të Ballkanit Perëndimor', që ka treguar se si grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë aktive në pika të nxehta të disa krimeve përeth botës. Ajo që është interesante është se drejtuesi (mbreti) i pretenduar koordinonte operacionet e tregtisë të drogës nga burgu në Ekuador.

Ne paraqesim një storje për kontrabandimin e armëve nga Europa Juglindore. Edhe pse ky rrezik nuk është i ri, problemi ka marrë vëmendje së fundi, sepse pistoletat, granatat dhe eksplozivët nga rajoni janë përdorur në dhunën e bandave në Ballkanin Perëndimor, dhe ka shqetësime se armët mund të bien në duar të ekstremistëve dhe terroristëve.

Gjinia është një temë e rralë që lidhet me krimin e organizuar. Në këtë botim, ne e shohim krimin e organizuar

përmes thjerrzës gjinore në Ballkanin Perëndimor për të kuptuar më mirë rregullat jo-formale që formojnë role të ndryshme për burrat dhe gratë, dhe për të nënvizuar se çfarë mund të bëhet për të hartuar kundërmasa për të ndryshuar qëndrimet, imazhet dhe sjelljet.

Në të kaluarën, Maqedonia e Veriut ka zhvilluar një reputacion për krimet kibernetike dhe ka prodhuar lamje të rreme. Së fundi, kompanitë në Maqedoninë e Veriut kanë qënë të goditura nga krimet kibernetike, sidomos përmes teknikës të njohur si fishing (phishing), që përdoret për të vjedhur të dhënat apo për të kryer mashtrim. Ne e sqarojmë se si funksionon dhe ndikimin e saj.

Çdo muaj, ne paraqesim një profil të një personi apo organizate që punon për të përforcuar rezistencën ndaj krimin të organizuar dhe korrupsionit. Në këtë botim, ne flasim me Dr. Anna - Maria Getos Kalac për Rrjetin Ballkanik të Kriminologjisë dhe çfarë ai bën për të përmirësuar studimin e krimin të organizuar në Ballkanin Perëndimor dhe për të ndërtuar rrjetet ndërmjet akademikëve, shoqërisë civile, medias dhe praktikantëve të drejtësisë penale në rajon.

Nëse dëshironi që të jeni në kontakt me ne apo dëshironi që të kontribuoni në Buletin e rrezikut, ju lutemi na kontaktoni në [almedina.dodic@globalinitiative.net](mailto:almedina.dodic@globalinitiative.net).

# Rrjeti i kapur shqiptar i kokainës drejtohet nga burgu në Ekuador.

Më 17 shtator të vitit 2020, Europoli ka lëshuar informacionin për operacionin e madh ndërkombëtar që ka shkatërruar Kompaninë Bello, një nga rrjetet shqipfolës më aktive të trafikimit të kokainës në Europë.<sup>1</sup> Më shumë se 20 persona janë arrestuar pas një hetimi pesëvjeçar të udhëhequr nga policia italiane dhe që përfshin agjencitë ligjzbatuese nga dhjetë shtete. Gjatë bastisjeve, reth katër ton kokainë dhe reth 5.5 milion € në para të gatshme janë konfiskuar nga ajo që u përshkrua si një sindikatë kriminale tejet profesionale.

Sipas Europolit, kreu i organizatës, një person 40 vjeçar i kombësisë shqiptare me qendër në Ekuador, ka përdorur teknologji të sofistikuar të koduar të komunikimit për të negociuar drejtëpërdrejtë me kartelët e drogës në Amerikën e Jugut; ka arranzhuar dërgesa të mëdha të kokainës në portet e mëdha në Europë; dhe, me ndihmën e bashkëpunëtorëve të vendosur në Itali, Hollandë dhe Shqipëri, ka organizuar shpërndarjen e drogës në Europë. Kokaina është kontrabanduar përtej

kufijve evropian e fshehur në automjete të pajisura me ndarje të fshehura të përpunuara.

Kriminelët me sa duket kanë pastruar të ardhurat e tyre duke përdorur një sistem alternativ nëntokësorë të dërgesave të origjinës kineze që njihet *sifei ch'ien*, që është i ngjajshëm me *hawala*. Media shqiptare ka spekuluar se drejtuesi është një person që quhet Dritan Rexhepi.<sup>2</sup> Është interesante, Rexhepi ka qënë i burgosur në Ekuador për gjashtë vitet e fundit që nga arrestimi i tij në gusht të vitit 2014 për tregti me drogë.

Rexhepi ka kaluar pjesën më të madhe të jetës në arrati. Ai është kërkuar për vrasjen e dy policëve në Shqipëri pasi arratisjes nga paraburgimi në vitin 2006. Pasi është arrestuar në Hollandë në vitin 2008, ai është ekstraduar në Itali. Në prill të vitit 2011, përderisa ka qënë në vuajtje të dënimit me burg për trafikim të drogës, ai është arratisur nga një burg në Pavia.<sup>3</sup> Pas disa muajsh, ai është akuzuar për grabitje të bankës dhe është



Një anije me kontejnerë mallrash ndalohet në portin e ujërave të thella të Guayaquil, Ekuador.

© Shutterstock/Al'fred

arrestuar në Spanjë, por është ekstraduar në Belgjikë ku po kërkohet për trafikim të drogës. Atje është arratisur për herë të tretë nga burgu, derisa është arrestuar në Ekuador në vitin 2014.<sup>4</sup>

Ky kriminel famëkeq mund të luajë një rol udhëheqës në koordinimin e operacioneve të tilla masive të trafikimit të kokainës nga qelia e tij e burgut në Ekuador, e kjo tregon jo vetëm fuqinë e rrjeteve kriminale shqiptare që funksionojnë jashtë Ballkanit Perëndimor, por edhe dobësinë e sistemit të drejtësisë penale në Ekuador.

Një raport i GI-TOC i korrikut të vitit 2020<sup>5</sup> 'Tentakulat transnacionale: Pikat e nxehta globale të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor' përshkruan se si gjatë njëzet viteve të fundit, grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor, duke përfshirë edhe Shqipërinë, kanë rritur vlerën në disa tregje të mëdha të drogës për tu bërë lojtarë të mëdhenj, sidomos në trafikimin e kokainës nga Amerika Latine në Europën Perëndimore.

Ekuadori duket se është i njohur për grupet kriminale sepse ndodhet ndërmjet Kolumbisë dhe Perusë, që bashkarisht prodhojnë rreth 90% të kokainës në botë. Gjithashtu është e lehtë për të hyrë dhe dalë ka mundësi të udhëtimit pa viza deri në 90 ditë, nuk ka bazë të të dhënave të gishtërinjëve apo foto të identitetit, dhe raportohet se është e lehtë të ndryshohet identiteti i një personi dhe të merren dokumente të falsifikuara, siç janë letërnjoftimet dhe pasaportat. Faktorë të tjerë kanë të bëjnë me ngjerjet e fundit të lidhura me paqëndrueshmërinë politike në vend, kufijtë e pakontrolluar, sistemin e dobët të drejtësisë penale,

ekonomi e bazuar në para kesh (që e bën të vështirë gjurmimin e flukseve financiare dhe është i lehtë pastrimi i parave) dhe korrupsionit në sistemin gjyqësorë. Burgjet e Ekuadorit kanë një histori të gjatë të korrupsionit dhe pasigurisë,<sup>6</sup> si dhe dhunës që lidhet me bandat.<sup>7</sup>

Gjithashtu është me rëndësi të përmendet se Ekuadori nuk ka ligj që siguron konfiskimin e aseteve nga trafikantët e drogës, dhe pothuajse aspak bashkëpunim, ndihmë të përbashkët ligjore, apo shkëmbim të zbulimit me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Rrjedhimisht, nuk është befasi që Drejtorati Nacional Kundër Drogës në Ekuador vlerëson se ndërmjet viteve 2017 dhe 2019, 56 shqiptarë që kanë qënë të lidhur me aktivitete të kundërligjshme kanë arritur në Ekuador.<sup>8</sup>

Sipas Shërbimit Nacional të Personave të privuar nga liria në Ekuador, Rexhepi do të ekstradohet në Shqipëri pasi të ketë vuajtur të gjithë dënimin prej 13 vitesh burg.<sup>9</sup> Deri tani ai ka përfunduar gjysmën e kohës të dërnimit me burg.

Ky rast tregon se përmirësimi i bashkëpunimit të ligjzbatuesve në kuadër të Ballkanit Perëndimor apo ndërmjet shteteve rajonale dhe Europolit do të jetë i pamjaftueshëm nëse kriminelët nga rajoni mund të funksionojnë lirisht në Amerikën Latine, edhe pasi që të arrestohen. Për të rritur kontrollin e drogës, do të nevojitet një marrëdhënie më efektive trekëndëshe ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor, Ballkanit Perëndimor dhe Amerikës Latine, duke përfshirë ndihmën e ndërsjellë ligjore, konfiskimin dhe rikuperimin e aseteve, ekstradimin, operacione të përbashkëta dhe të shkëmbimit të zbulimit.

## Shënime

- 1 Europol, Ekipi i përbashkët hetimor çon drejtë shkatërrimit një prej rrjeteve më aktive shqip-folëse të trafikimit të kokainës në Europë, 17 shtator, 2020, <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/joint-investigation-team-leads-to-dismantling-of-one-of-europe%E2%80%99s-most-active-albanian-speaking-networks-trafficking-cocaine>.
- 2 *Si funksiononte karteli i kokainës? Hoxha: Dritan Rexhepi rrinte në hije, niste ngarkesat nga burgu*, ABC News Shqipëri, 17 Shtator shtator 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=cm8mY921Xv4>. Një lojtar tjetër kryesor që është identifikuar nga media është Eldi Dizdari, një shqiptar që jeton në Dubai.
- 3 'Si u arratisa nga qelita e Shqipërisë, Italisë dhe Spanjës', rrëfimi nga burgu në Ekuador i Dritan Rexhepit, Gazeta Shqiptare, 11 Shkurt 2020, <http://gazetashqiptare.al/2020/02/11/si-u-arratisa-nga-qelita-e-shqiperise-italise-dhe-spanjes-rrfimi-nga-burgu-ne-ekuador-i-dritan-rexhepit/>.
- 4 *Belgijke arratiset nga burgu Dritan Rexhepi*, Tema, 2 Tetor 2011, <http://www.gazetatema.net/2011/10/02/belgijke-arratiset-nga-burgu-dritan-rexhepi/>.
- 5 Walter Kemp, *Tentakulat transnacionale, pikat e nxehta globale të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, Korrik 2020*, [https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ENGLISH\\_MRES.pdf](https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ENGLISH_MRES.pdf).
- 6 *21 detenidos por ingreso de armas en supuesta ambulancia a la Penitenciaría*, El Universo, 17 Shkurt 2019, <https://www.eluniverso.com/noticias/2019/02/17/nota/7194221/21-detenidos-ingreso-ambulancia-penitenciaria-litoral>.
- 7 *Desde la cárcel de Latacunga, un albanés dirigió un emporio de droga en Europa*, Plan V, 21 Shtator 2020, <https://www.planv.com.ec/historias/sociedad/desde-la-carcel-latacunga-un-albanes-dirigio-un-emporio-droga-europa>.
- 8 Po aty.
- 9 Po aty.

# Armët e kundërligjshme në Ballkanin Perëndimor: një kërcënim për Europën.

Më 30 shtator të vitit 2020, pothuajse 9000 persona nga personeli ligjzbatues kanë marrë pjesë në operacionin e përbashkët kundër krimit të organizuar në Europën Juglindore.<sup>1</sup> Operacioni katër ditor, i mbështetur nga Europol synoi të luftonte imigrimin dhe trafikimin kundërligjor. 166 persona janë arrestuar me akuza që lidhen me trafikimin e armëve, njerëzve dhe drogës. Më shumë se 51 armë të llojeve të ndryshme janë konfiskuar.

Kontrabandimi i armëve nga Ballkani Perëndimor është bërë një shqetësim që nga viti 1990, dhe me sa duket, problemi nuk është pakësuar: 'Milionë të armëve të lehta që kanë qarkulluar në Ballkanin Perëndimor paraqesin një rrezik të madh për sigurinë europiane,' ka thënë Ministri i punëve të jashtme të Francës Jean-Yves Le Drian në një konferencë të përbashkët me kolegun e tij gjerman, Heiko Maas, në dhjetor të vitit 2018.<sup>2</sup> Policia në Suedi, e shqetësuar nga rritja e dhunës të bandava ka regjistruar një rritje në përdorimin e pistoletave, revolverëve, armëve automatike dhe madje dhe granatave të kontrabanduara nga Ballkani Perëndimor. Dhe lufta e vazhdueshme ndërmjet klaneve të Malit të Zi

është karakterizuar me dhunë duke përdorur lloje të ndryshme të armëve, duke përfshirë armët atuatike dhe eksplozivët plastik. Sa serioz është furnizimi i armëve të kundërligjshme në Ballkanin Perëndimor? Dhe cilat janë rreziqet për rajonin dhe përtej?


Europa Juglindore është mbushur me armë të mbetura nga luftërat në ish Jugosllavi, duke përfshirë ato që janë importuar gjatë viteve 1990, armë që kanë mbetur pas nga Armata nacionale jugosllave, dhe ata që janë përdorur në Kosovë në vitin 1999 dhe në Maqedoninë e Veriut në vitin 2001. Armët gjithashtu u plaçkitën nga armatimet gjatë trazirave civile në Shqipëri në vitin 1997. Sipas vlerësimeve konzervative nga KB dhe Europol, si dhe nga ekspertët rajonal ka më shumë se 3 milion armë të kundërligjshme në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor bashkë me Kroacinë.<sup>3</sup> Kjo është një mesatare prej 30 armësh (armë zjarri legale dhe të kundërligjshme) per 100 banorë.<sup>4</sup>

Anketa e bërë në Gjenevë për armët e vogla tregon se në vitin 2017, Mali i Zi dhe Serbia, secila me 39.1 armë për 100 banorë rradhiten të tretat në botë dhe të parat



Rezervat e armëve të zjarrit u konfiskuan në Vlorë, Shqipëri, Gusht 1997.



© Alain Nogues/Sygma/via Getty Images



Shtetet e Bashkuara	120.5	Islanda	31.7	Suedia	23.1
Jemeni	52.8	Bosnja dhe Hercegovina	31.2	Pakistani	22.3
Mali i Zi	39.1	Austria	30.0	Portugalia	21.3
Serbia	39.1	Maqedonia	29.8	Franca	19.6
Kanada	34.7	Norvegjia	28.8	Gjermania	19.6
Uruguai	34.7	Malta	28.3	Iraku	19.6
Qiproja	34.0	Zvicra	27.6	Luksemburgu	18.9
Finlanda	32.4	Zelanda e re	26.3		

**FIGURA 1** Shkalla e vlerësuar e mbajtësve të armëve civile të zjarrit në 25 shtetet dhe territoret e vlerësuar më lartë, 2017 (armë zjarri për 100 rezidentë).

BURIMI: Aaron Karp, Vlerësimi i i numrave global të armëve të zjarrit të mbajtura nga civilët, Anketë e armëve të vogla, Qershor 2018, [www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/T-Briefing-Papers/SAS-BP-Civilian-Firearms-Numbers.pdf](http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/T-Briefing-Papers/SAS-BP-Civilian-Firearms-Numbers.pdf).



Shteti	Shuma e vlerësuar e armëve të kundërligjshme
Shqipëria	210 000 <sup>6</sup>
Bosnja dhe Hercegovina	750 000 <sup>7</sup>
Kroacia	600 000 <sup>8</sup>
Kosovo*	200 000 <sup>9</sup>
Mali i Zi	170 000 <sup>10</sup>
Maqedonia e Veriut	500 000
Serbia	1 000 000 <sup>11</sup>

**FIGURA 2** Numri i vlerësuar i armëve të kundërligjshme sipas shteteve, rajoni i Ballkanit

\*Shënim: Përcaktimi i Kosovës është pa paragjykuar pozitat mbi statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të drejtësisë mbi deklaratën e pavarësisë të Kosovës.

BURIMI: Anкета e armëve të vogla, Mbjtësit e armëve civile, 2017, [http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/Weapons\\_and\\_Markets/Tools/Firearms\\_holdings/SAS-BP-Civilian-held-firearms-annexe.pdf](http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/Weapons_and_Markets/Tools/Firearms_holdings/SAS-BP-Civilian-held-firearms-annexe.pdf)

në Europë për mbajtje të armëve nga civilët. Shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor janë gjithashtu lartë në listë: Bosnja dhe Hercegovina rradhitet e pesta dhe e nënta në botë (31.2 për 100 banorë); Maqedonia e Veriut është e shtata në Europë dhe e 13-ta në botë me 29.8 për 100 banorë; Kosova rradhitet e 11-ta në Europë me 23.9 për 100 banorë dhe e 16-ta në botë.<sup>5</sup>

Pothuajse të gjithë llojet e armëve të vogla, armët e shkallës ushtarake mund të furnizohen në Ballkanin Perëndimor dhe Kroaci, madje edhe armët kundërtankut, eksplozivët, raketahedhës dorë dhe pistoletat të lehta kundër fluturakeve.

### Kontrabandimi, përdorimi dhe çmimet e armëve të kundërligjshme

Shumica e këtyre armëve janë të fshehura në shtëpitë e njëjërëzve, në tregun e zi apo në zotërim të kriminelëve. Që nga viti 2015, një mori e vrasjeve në lidhje me një luftë ndërmjet grupeve kriminale në Mal të Zi ka vrarë dhjetëra në incidente që përfshijnë armë automatike apo eksploziv plastik.

Çmimi mesatar i armëve në Ballkanin Perëndimor varion nga €10 për një granatë dore deri në €150–400 për një pistoletë.<sup>12</sup> Pushkët gjysëm automatike kushtojnë

ndërmjet €150 dhe 300, kurse pushkët automatike janë reth €200 deri në 400.

Eksplzivët nga Ballkani Perëndimor gjithashtu mund të gjenden në tregun e zi: eksplozivi i plastikës C4 kushton ndërmjet €1 500 dhe 4 000 për kilogram. Deri në vitin 1991, vetëm katër shtete në botë, duke përfshirë edhe ish Jugosllavinë, kanë prodhuar këtë lloj të eksplozivit. Është prodhuar në fabrikën ushtarake në Berane (tani Mali i Zi). Eksplozivët e plastikës janë të shpërndarë gjërësisht nga kriminelët në Mal të Zi dhe Serbi, sidomos për shpërthim të automjeteve – në 13 shtator të vitit 2020, pretendohet se ky lloj i eksplozivit është përdorur për të shpërthyer një automjet në Beograd.

Kur flasim për kontrabandimin e armëve të kundërligjshme, kriminelët nga Ballkani Perëndimor janë të lidhur mirë me trafikantët e armëve nga Kroacia dhe Sllovenia, ku ka patur disa konfiskime të mëdha të armëve.<sup>13</sup> Armët e kundërligjshme kontrabandohen nga rrjetet e krimit të organizuar nëpër Europë. Zakonisht përfshijnë grupe të përfshira në trafikimin e kundërligjshëm të mallrave tjera (siç është droga). Në disa raste, armët janë tregtuar për drogë. Armët nga Ballkani Perëndimor janë gjetur në Austri, Francë, Gjermani, Itali, Hollandë, Spanjë, Suedi, dhe në MB.<sup>14</sup> Disa prej këtyre armëve përdoren nga grupet kriminale; të tjerat përfundojnë në duart e terroristëve.

Agjencia Nationale e Krimit në MB ka paralajmëruar se numri i armëve të kundërligjshme në MB do të vazhdojë të rritet; armët nga Ballkani Perëndimor janë në krye të tregut të kundërligjshëm.<sup>15</sup> Agjencia frikësohet se disa prej armëve të kundërligjshme nga Ballkani Perëndimor mund të përdoren në sulme terroriste.

Në Suedi, numri i vrasjeve të lidhura me grupet e krimit të organizuar që përdorin armë të kundërligjshme nga Ballkani Perëndimor është në rritje.<sup>16</sup> Blerësit e armëve të kundërligjshme janë anëtarët e grupeve kriminale të organizuara, dhe bandat. Në këtë shtet që është zakonisht paqësor, ka 320 incidente dhe 42 vdekje në vitin 2019 për shkak të dhunës me armë,<sup>17</sup> duke përfshirë një numër shokues të rasteve që përfshijnë granatat e dorës M-75 të prodhuara në ish Jugosllavi. Këto mund të blihen për vetëm 100 krona (€9.60).<sup>18</sup>

Sipas policisë franceze, terroristët e përfshirë në sulmet e Parisit në janar dhe nëntor të vitit 2015, duke përfshirë edhe masakrën në sallën e koncerteve Bataklan, kanë përdorur armë të kundërligjshme nga

Ballkani Perëndimor.<sup>19</sup> Ghithashtu ka raporte të armëve të prodhura në Ballkan që përfundojnë në zona të luftës në Siri.<sup>20</sup>

Bandat me motoçikleta janë gjithashtu të përfshirë në trafikimin e kundërligjshëm të armëve nga Ballkani Perëndimor. Kontaktet që më parë kanë trafikuar drogë dhe njerëz tani shfrytëzohen për të kontrabanduar armë. Famëkeqët vëllezër Kulum, të cilët ishin aktiv në bandën e motoçikletave Tribuna e Bashkuar, siç duket po operojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë pasi janë ndaluar nga Gjermania si kërcënim për sigurinë kombëtare.<sup>21</sup> Pretendohet se ata janë të përfshirë në trafikimin e drogës dhe armëve në Gjermani, Austri, dhe Zvicër.<sup>22</sup> Grupet tjera, si Bandidos në Geteborg po flitet se po zgjerojnë kontaktet e tyre në Ballkan.<sup>23</sup> Rruga më e njohur për trafikimin e armëve në Ballkanin Perëndimor është rruga e Ballkanit.

BE ka njohur problemin e armëve të kundërligjshme në Ballkanin Perëndimor dhe është përfshirë në programet e përbashkëta me qeveritë rajonale. Në vitin 2017, Franca dhe Gjermania kanë filluar një iniciativë për të shtypur kontrabandimin e armëve të zjarrt në Ballkanin Perëndimor me një plan veprimi deri në vitin 2024.<sup>24</sup> Si pjesë e procesit të Berlinit, është miratuar një udhërrëfyes për zgjidhje të qëndrueshme për posedimin e kundërligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe armëve të lehta, dhe municionit, në samitin e Ballkanit Perëndimor në Londër në korrik të vitit 2018.<sup>25</sup> Duke patur parasysh numrin e armëve në qarkullim, nevojitet veprim urgjent për të zvogëluar rrezikun e këtyre armëve që bien në duart e kriminelëve dhe terroristëve.



**Një lloj granatë dore dhe bombë M-75**

© WikiCommons



## Shënime

- 1 Europol, 166 të arrestuar në aksionin ndërkombëtar kundër kimit të organizuar në Europën Juglindore, 30 shtator; 2020, <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/166-arrested-in-international-crackdown-against-crime-in-southeast-europe>.
- 2 Ballkani Perëndimor European, Mlnistri i Punëve të Jashtme të Francës: Armët e vogla nga Ballkani Perëndimor janë kërcënim për sigurinë europiane, 11 dhjetor të vitit 2018, [www.europeanwesternbalkans.com/2018/12/11/french-foreign-minister-small-arms-western-balkans-threat-european-security/](http://www.europeanwesternbalkans.com/2018/12/11/french-foreign-minister-small-arms-western-balkans-threat-european-security/).
- 3 Ted Leggett, Krimi dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe vendet e ndikuara, UNODC, Mars 2008, [www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Balkan\\_study.pdf](http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Balkan_study.pdf).
- 4 Aaron Karp, Vlerësimi i numrave global të armëve të zjarrit të mbajtura nga civilët, dokumenti i shkurtër i anketës për armët e vogla, Qershor, 2018, [www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/T-Briefing-Papers/SAS-BP-Civilian-Firearms-Numbers.pdf](http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/T-Briefing-Papers/SAS-BP-Civilian-Firearms-Numbers.pdf).
- 5 Po aty.
- 6 Për këtë figurë shihni <https://www.politico.eu/article/the-european-nation-with-a-deadlier-gun-culture-than-the-us-albania/>.
- 7 750 000 armë në BH, [https://www.ba.undp.org/content/bosnia\\_and\\_herzegovina/en/home/presscenter/articles/2015/03/07/arms-control-exchange-bosnia-and-herzegovina-and-argentina.html#:~:text=Small%20arms%20are%20also%20problematic,1990s%2C%20are%20still%20in%20circulation](https://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/en/home/presscenter/articles/2015/03/07/arms-control-exchange-bosnia-and-herzegovina-and-argentina.html#:~:text=Small%20arms%20are%20also%20problematic,1990s%2C%20are%20still%20in%20circulation).
- 8 Shihni <https://zadarski.slobodnadalmacija.hr/zadar/forum/vecimamo-500-000-komada-ilegalnog-naoruzanja-a-sada-ce-se-taj-broj-i-povecati-461630>.
- 9 Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara thekson se ka 260 000 armë; shihni [https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KSSP/KSSP%20Brochure\\_Final%20ENG%20sz.pdf](https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KSSP/KSSP%20Brochure_Final%20ENG%20sz.pdf).
- 10 Institucionet theksojnë se ka 900 000; shihni <https://www.rs.undp.org/content/serbia/en/home/presscenter/articles/2016/07/14/there-is-a-clear-correlation-between-illicit-firearms-and-violence.html>.
- 11 Raporti i Anketës për armët e vogla 141 464, [http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/Weapons\\_and\\_Markets/Tools/Firearms\\_holdings/SAS-BP-Civilian-held-firearms-annexe.pdf](http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/Weapons_and_Markets/Tools/Firearms_holdings/SAS-BP-Civilian-held-firearms-annexe.pdf).
- 12 Informacioni mbi koston e llojeve të ndryshme të armëve është bazuar në të dhënat e besueshme nga tregjet kriminale, si dhe nga policia dhe dokumentet e gjykatës.
- 13 Europol, Policia bastis adresa në Kroaci për të shkatërruar rrjetin e trafikimit të armëve, 20 qershor i vitit 2018, [www.europol.europa.eu/newsroom/news/police-raids-addresses-across-croatia-to-break-arms-trafficking-network](http://www.europol.europa.eu/newsroom/news/police-raids-addresses-across-croatia-to-break-arms-trafficking-network).
- 14 Europol, Trafikimi i kundërligjshëm i armëve, [www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/illicit-firearms-trafficking](http://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/illicit-firearms-trafficking).
- 15 Charles Hymas, Bandat blejnë armë për gjuajtje para se të importojnë ata në MB mes rries rritjes të armëve të zjarrit për të zbatuar drogën, *The Telegraph*, 14 Prill 2020, [www.telegraph.co.uk/politics/2020/04/14/gangs-buy-blank-firing-guns-online-importing-uk-amid-rise-firearms](http://www.telegraph.co.uk/politics/2020/04/14/gangs-buy-blank-firing-guns-online-importing-uk-amid-rise-firearms).
- 16 Lee Roden, Pse bandat suedeze përdorin granata dore (dhe çfarë bën shteti për një gjë të tillë), *SE Lokale*, 28 Shkurt 2018, [www.thelocal.se/20180228/why-sweden-is-battling-hand-grenades-and-illegal-weapons](http://www.thelocal.se/20180228/why-sweden-is-battling-hand-grenades-and-illegal-weapons).
- 17 Paulina Neuding, Krimi i dhunshëm po rritet. Kur do të reagojnë politikanët?, *The Spectator*, 29 Dhjetor 2018, [www.spectator.co.uk/article/violent-crime-in-sweden-is-soaring-when-will-politicians-act-;](http://www.spectator.co.uk/article/violent-crime-in-sweden-is-soaring-when-will-politicians-act-;) see gjithashtu: Qytetet e mëdha suedeze shohin rënie të numrit të të shtënave, *SE Lokale*, 7 Janar 2020, [www.thelocal.se/20200107/fewer-shootings-in-swedens-big-cities-in-2019](http://www.thelocal.se/20200107/fewer-shootings-in-swedens-big-cities-in-2019).
- 18 Karis Hustad, Suedia ka problem me granatat e dorës, dhe kjo është arsyeja, *Euronjuz*, 11 prill 2018, [www.euronews.com/2018/04/10/sweden-has-a-problem-with-hand-grenades-and-here-s-why](http://www.euronews.com/2018/04/10/sweden-has-a-problem-with-hand-grenades-and-here-s-why). Hulumtim vijues, një ekip ndër-institucional i kriminologëve dhe hulumtuesve ka numëruar 78 raste të eksplozimeve të granatave të dorës ndërmjet 2010 dhe 2017, me gjysmën e atyre rasteve që kanë ndodhur në vitin 2016. Shihni *Kriminologiska funderingar, Förtydligande om internationell jämförelse av handgranatsdetonationer*, 11 Shtator 2017, [www.mgerell.blogspot.com/2017/09/fortydligande-om-internationell.html](http://www.mgerell.blogspot.com/2017/09/fortydligande-om-internationell.html).
- 19 Jasmina Rose, *Islamski teroristi opskrbliju se oruzjem s Balkana*, *Deutsche Welle*, 4 Shkurt 2020, [www.dw.com/hr/islamski-teroristi-opskrbliju-se-oruzjem-s-balkana/a-52244446](http://www.dw.com/hr/islamski-teroristi-opskrbliju-se-oruzjem-s-balkana/a-52244446).
- 20 L. T., *Trogodišnje terensko istraživanje: Hrvatske rakete u rukama boraca Islamske države*, *Novi list*, 15 Dhjetor 2017, [www.novillist.hr/Vijesti/Hrvatska/Trogodisnje-terensko-istrazivanje-Hrvatske-rakete-u-rukama-boraca-Islamske-drzave/](http://www.novillist.hr/Vijesti/Hrvatska/Trogodisnje-terensko-istrazivanje-Hrvatske-rakete-u-rukama-boraca-Islamske-drzave/).
- 21 *Član moto bande: Postali smo prejaki pa su hteli da nas skloni!*, *Kurir*, 7 Janar 2014, <https://www.kurir.rs/planeta/1168173/clan-moto-bande-postali-smo-prejaki-pa-su-hteli-da-nas-sklone>.
- 22 Višnja Kragić Mahmutović, *Na čelu opasne bande: Braća Ćulum su državna opasnost*, 24 sata, 24 Prill 2019, [www.24sata.hr/news/na-celu-opasne-bande-braca-culum-su-drzavna-opasnost-626082](http://www.24sata.hr/news/na-celu-opasne-bande-braca-culum-su-drzavna-opasnost-626082).
- 23 Claes Petersson dhe Daniel Olsson, *De leder MC-gängen där du bor - här är listan*, 28 Dhjetor 2016, *Expressen*, [www.expressen.se/nyheter/de-leder-mc-gangen-dar-du-bor-har-ar-listan/](http://www.expressen.se/nyheter/de-leder-mc-gangen-dar-du-bor-har-ar-listan/).
- 24 Këshilli i Bashkimi European, Vendimi i Këshillit (CFSP) 2019/2111 në mbështetje të SEESAC aktivitetet e çarmatimit dhe kontrollit i armëve në Europën Juglindore zvogëlojnë kërcënimin e armëve të vogla të kundërligjshme dhe armëve të lehta dhe municionit të tyre, 10 dhjetor 2019, [www.eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019D2111&from=EN](http://www.eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019D2111&from=EN).
- 25 Udhërrëfyty për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin e kundërligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të vogla dhe armëve të lehta (SALW) dhe municionin e tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024, SEESAC, 27 Shtator 2019, [www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf](http://www.seesac.org/f/docs/publications-salw-control-roadmap/Regional-Roadmap-for-a-sustainable-solution-to-the.pdf).

# Krimi i organizuar përmes këndvështrimit gjinor.

'Ne punuam për 45 ditë duke tharë, pastruar dhe paketuar kanabisin që do të dërgohej në Itali nga brigjet e Kurbinit. Ishte një përvojë intensive por e kënaqshme. Për tetë orë, ne paguheshim 2 000 Lekë [€16]; Në punonim ?? orë, mund të fitonim 2 500 Lekë [€19]. Me paratë që fitonim, blija rroba dhe libra për shkollë për tre fëmijët e mi.<sup>1</sup>

'Është fatkeqësi se në një vit kjo punë zgjat jo më shumë se ?? ditë. Unë dhe bashkëshorti nuk kemi punë tjetër dhe nëse punojmë më shpesh do të ishte më fitimprurëse.<sup>2</sup>

Dy gra të angazhuara në kultivimin e kanabisit në Shqipëri, që na treguan tregimet e tyre, ofruan informacion për rolin e grave në akvitetet e kundërligjshme. Raportet e grave që janë angazhuar në kultivimin e kanabisit në Shqipëri janë që nga fillimi i viteve ????, kur ato mbillnin kanabis në kopshtet e tyre.<sup>3</sup> Që atëherë, besohet se gratë kanë luajtur një rol

kryesor në industri, të specializuara kryesisht në procesin e pastrimit të kanabisit.

Rastet janë të rralla, por grate janë përfshirë gjithashtu në më shumë pozita të larta në grupet kriminale në rajon. Në 22 shtator të vitit 2020, një grua serbe që udhëhiqte një grup ndërkombëtar të trafikimit të kanabisit ishte arrestuar në Spanjë së bashku me 30 anëtarë të grupit (kryesisht nga Serbia, Kroacia dhe MB), disa prej të cilëve kanë patur histori kriminale në Serbi dhe kërkoheshin nga autoritetet.<sup>4</sup> Përveç asaj, 12 600 bimë, 190 kilogram sytha të përpunuara dhe €50 000 para të gatshme janë konfiskuar.<sup>5</sup> Rrjeti kishte më shumë se dhjetëra objekte të kultivimit të brendshëm në afërsi të Barcelonës, të pajisura me teknologji të kultivimit të shpejtë. Produkti i tyre është shpërndarë në Katalunja. Sipas autoriteteve spanjolle, kjo ishte organizata më e rëndësishme kriminale e përfshirë në trafikimin e kanabisit që është shkatërruar këtë vit.<sup>6</sup>



Një grua shqiptare me bimët e konfiskuara të marihuanës pas bastisjes policore në Lazarat, Shqipëria, Qershor, 2014.

© Gent Shkullaku/AFP via Getty Images

Ka një numër në rritje të studimeve globale që analizojnë rolin e grave në grupet e krimit të organizuar rreth botës, duke parë rolin e tyre qoftë si viktimë dhe si kryerëse.<sup>7</sup> Politikbërësit janë duke njohur gjithnjë e më shumë rolin e gjinisë në formimin e rrezikshmërive të individëve në krimin e organizuar. Në Ballkanin Perëndimor, megjithatë, lidhja ndërmjet gjinisë dhe krimit të organizuar mbetet pak e studiuar. Disa raporte në rajon i kushtojnë vëmendje rolit të gruas në krimin e organizuar, dhe vetëm disa shohin në perceptimet gjinore në lidhje me krimin e organizuar dhe nëse gjinia ndikon, pse dhe si përfshihen njerëzit.<sup>8</sup>


Faktorët socio ekonomik sigurisht që luajnë rol në aspekt të rritjes të rrezikshmërisë të krimit të organizuar. Për shembull, 49 individ (burra dhe gra) të intervistuar për një studim të fundit, kanë identifikuar unanimisht vështirësitë ekonomike si motiv për pjesëmarrjen e tyre në kultivimin e kundërligjshëm të kanabisit.<sup>9</sup> Por megjithatë ndikimet socio ekonomike janë gjërësisht të njohura, ka më pak fokus në atë se si ata ndikojnë te gratë në mënyra të ndryshme, dhe çfarë do të thotë kjo

për atë se si formësohet rrezikshmëria për burrat dhe gratë ndaj krimit të organizuar.

Disa tregues udhëheqës tregojnë se gratë përballen me vështirësi më të mëdha ekonomike se burrat në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, siç është treguar në Figurën 3, papunësia në rajon është e lartë – sidomos për gratë e reja.

Në vitin 2019, kishte gjithashtu hendek gjinor në lidhje me pagat, mesatarisht 10% në Shqipëri, 13.9% në Mal të Zi dhe rreth 12% në Maqedoninë e Veriut. Në të njëjtin vit, në Serbi, paga mesatare mujore për gratë ishte €30 më e ulët se ajo e burrave.<sup>10</sup>


Nëse vështirësitë ekonomike ishin një faktor domethënës që i shtynte njerëzit në krim të organizuar si një burim i të ardhurave, burgjet në Ballkanin Perëndimor do të supozohej se do të ishin plotë me gra. Megjithatë, ky nuk është rasti. Siç është parë në Figurën 4, që jep një pasqyrë të popullsisë të burgjeve në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2019, numri i grave pas



**FIGURA 3** Një grua shqiptare me bimët e konfiskuara të marihuanës pas bastisjes policore në Lazarat, Shqipëria, Qershor, 2014.

BURIMI: Banka Botërore, Të dhënat e hapura të Bankës Botërore, <https://data.worldbank.org/>

## NUMRI I TË BURGOSURVE (MESHKUJ DHE FEMRA) NË BALLKANI PERËNDIMOR



**FIGURA 4** Popullsia e burgjeve në Ballkanin Perëndimor, 2019.

BURIMI: M Aebi dhe M Tiago, Popullsia e burgjeve, SPACE I – 2019, Këshilli i Europës, [https://wp.unil.ch/space/files/2020/04/200405\\_FinalReport\\_SPACE\\_I\\_2019.pdf](https://wp.unil.ch/space/files/2020/04/200405_FinalReport_SPACE_I_2019.pdf); Shërbimet Korrigjuese të Kosovës, Statistikat, <https://shkk.rks-gov.net>

grilave është një përqindje shumë e vogël e numrit të përgjithshëm. Në fund të vitit 2019, 4.1% apo më pak nga popullsia e përgjithshme në burg në të gjithë shtetet e Ballkanit Perëndimor ishin gra.<sup>11</sup> Përveç kësaj, shumë prej këtyre dënimeve janë të lidhura me krime të vogla (mashttrim dhe grabitje) dhe jo aktivitete të organizuara kriminale. Që nga viti 2015, numri i grave të dënuara për krime të lidhura me drogën në Shqipëri është rritur, duke përfshirë dënimet nga keqpërdorimi i drogës, dhe aktivitetet që lidhen me krimin e organizuar.<sup>12</sup>

Statistikat zyrtare gjithashtu theksojnë se roli i grave në krimin e organizuar është i kufizuar: të dhënat e Ministrisë të Punëve të Brendshme në Serbi për vitin tregojnë se thuhetse 95% e anëtarëve nga grupet e krimin të organizuar në Serbi janë burra.<sup>13</sup>

Edhe pse kjo sygjeron se krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor është botë e burrave, është themelore të njohim se perceptimet gjinore formësojnë jo vetëm rolin e luajtur nga individët në krimin e organizuar, por gjithashtu edhe përgjigjet e ligjzbatuesve dhe modelet e ndalimit. Popullsia e burgjeve dhe statistikat zyrtare mund të japin një pasqyrim të shtrembëruar të peizazhit kriminal të Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, është e qartë se në Ballkanin Perëndimor krimi dhe burrëria janë të lidhura ngushtë. Anëtarësimi në një grup kriminal mund të jetë tërheqës për disa të rinj që të ndjehen të fuqizuar, dhe të arrijnë statusin dhe pasurinë që nuk mund të arrijnë në mënyrë tjetër në komunitetin e tyre.



## Anëtarët e rinj të bandës shqiptare spikasin simbolet materiale të statusit të tyre.

Burimi: Mediat sociale

Imazhi i krimit, siç është shpërndarë dhe ndarë në mediat social dhe në kulturën e popullit, shpesh portretizon anëtarin e bandës si një të ri të fortë, të pavarur dhe të fuqishëm që është bërë i suksesshëm në komunitetin e tij apo jashtë vendit, i ri të cilin e respekton apo e ka frikë komuniteti lokal dhe është një model i mundshëm për t'u ndjekur nga personat e rinj.<sup>14</sup>

Gratë, nga ana tjetër, tradicionalisht shihen në rajon se kujdesen për familjen. Rrjedhimisht ky koncept parashikon që gratë luajnë një rol të kufizuar të ndihmuar nga burrat e tyre apo angazhohen në krim të organizuar përmes përfshirjes të tyre jo të dhunshme apo në detyra mbështetëse

Këto role prapa skenës janë më rrallë në qendër të përpjekjeve të ligjzbatuesve. Në fakt, roli që po luajnë

gratë në rrjetet e krimit të organizuar, së bashku me perceptimet gjinore të kriminalitetit ndërmjet ligjzbatuesve, mund të nënkuptojë se gratë janë pak të përfaqësuara në statistikat e krimit të organizuar.

Fokusi i kufizuar mbi rolin që luan gjinia në krimin e organizuar dhe mungesa e të dhënave në dispozicion të lidhura me gjininë në Ballkanin Perëndimor e bëjnë të vështirë vlerësimin me saktësi të rolit dhe përfshirjes të grave në grupet kriminale. Por nëse shohim krimin e organizuar përmes thjerrzës gjinore jo vetëm që ndihmon që të kuptohen më mirë rregullat joformale dhe ritet që formësojnë rolet e përcaktura gjinore për burrat dhe gratë, por gjithashtu mund të kontribuojnë për përcaktimin e kundërmasave të duhura që mund të ndryshojnë qëndrimet, imazhet dhe sjelljet, dhe të përforcojnë rezistencën e komunitetit.

## Shënime

- 1 Intervistë me gruan nga Zheja të angazhuar në kultivimin e kanabisit, Mars 2020.
- 2 Intervistë me gruan nga Poro të angazhuar në kultivimin e kanabisit, 18 janar 2020.
- 3 Një intervistë me gruan nga Bolene, që është një kultivuese e mëparshme e kanabisit, Shkurt 2020.
- 4 ATV, *Srpkinja na čelu narko-bande: Hapšenje u Španiji, pokrenuta policijska akcija*, 8 Shtator 2020, ATV, <https://www.atvbl.com/vijesti/svijet/srpkinja-na-celu-narko-bande-hapjenje-u-spaniji-pokrenuta-policijska-akcija-28-9>.
- 5 Mondo, *OPASNE SRPKINJE: Nekoliko žena iz Srbije bile na čelu narko-mafije! Za jednom su posebno tragali!*, 5 Tetor 2020, <https://mondo.me/Info/EX-YU/amp/a876698/Srpkinje-na-celu-narko-bandi-sverc-droga.html>.
- 6 Enrique Figueredo, *Cae una banda de traficantes de marihuana dirigida desde Valls por una serbia que acababa de tener un bebé*, 22 Shtator 2020, La Vanguardia, <https://www.lavanguardia.com/sucesos/20200922/483625919108/barcelona-tarragona-marihuana-guardia-civil-valls-mujer-serbia.html>.
- 7 Europol, *Krimi nuk ka gjini: Takoni të arratisurat më të kërkuara të Europës*, Europol, 18 tetor, 2019, <https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/crime-has-no-gender-meet-europe%E2%80%99s-most-wanted-female-fugitives>.

- 8 Ky artikull njih gjininë si jo-binare dhe kupton që anëtarët e komunitetit LGBTQI do të përjetojnë dhe reagojnë ndryshe ndaj krimit të organizuar.
- 9 Fatjona Mejdini, Kultivimi i kanabisit në Shqipëri. Një vlerësim, 2020 (e pabotuar).
- 10 Zyra e statistikave e Republikës të Serbisë, Pagat mesatare sipas rajoneve, nivelet e kuantifikimit dhe seksi, <https://data.stat.gov.rs/Home/Result/2403040509?languageCode=en-US>; Center of Investigative Journalism in Montenegro, *NEJEDNAKE PLATE ŽENAMA U ODNOSU NA MUŠKARCE: Diskriminacija i po novčaniku*, 1 Mars 2020, <http://www.cin-cg.me/nejednake-plate-zenama-u-odnosu-na-muskarce-diskriminacija-i-po-novcaniku/>; Radio MOF, Родов јаз во плати во Македонија, 10 April 2018, <https://www.radiomof.mk/infografik-rodov-jaz-vo-plati-vo-makedonija/>; INSTAT, Gratë dhe burrat në Shqipëri 2020, 2020, <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/publication/2020/women-and-men-in-albanian-2020/>.
- 11 Përqindja e femrave të burgosura: 1.7% (86) e të gjithë të burgosurve në Shqipëri janë femra; 2.2% (35) në Kosovë; 2.6% (30) në Mal të Zi; 3.3% (70) në Maqedoninë e Veriut dhe 4.1% (441) në Serbi. Nuk ka të dhëna konkrete që janë të disponueshme për Bosnjën dhe Hercegovinën, ku është vlerësuar se gratë përbëjnë rreth 3–10% të popullsisë të përgjithshme në burgje. See M Aebi dhe M Tiago, *SPACE I – 2019*, Këshilli i Europës, statistikat vjetore penale: popullsia e burgjeve, [https://wp.unil.ch/space/files/2020/04/200405\\_FinalReport\\_SPACE\\_I\\_2019.pdf](https://wp.unil.ch/space/files/2020/04/200405_FinalReport_SPACE_I_2019.pdf); Shërbimet korrektuese të Kosovës, Statistikat, <https://shkk.rks-gov.net>; *Ženski zatvori u BiH imaju problema s kapacitetom*, Zenit, 11 Nëntor 2019, <https://www.zenit.ba/zenski-zatvori-u-bih-imaju-problema-s-kapacitetom/>.
- 12 INSTAT, Kryerësit sipas veprave penale dhe seksit. Drejtoria e përgjithshme e burgjeve, <http://instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/crimes-and-criminal-justice/#tab2>.
- 13 Të dhënat e prezantuar në një takim ndërmjet Grupit të punës të Konventës nacionale të kapitullit 24 të BE-së dhe Grupi negociues i Qeverisë të Serbisë mbi Drejtësinë, Lirinë, dhe Sigurinë, Beograd, 18 Shkurt 2020.
- 14 *Mladi kriminalci u Srbiji su zvezde Instagrama, a evo ko je najviše kriv za to*, *Telegraf*, 24 Korrik 2019, <https://www.telegraf.rs/amp/zivot-i-stil/porodica-zivot-i-stil/3085559-mladi-kriminalci-u-srbiji-su-zvezde-instagrama-a-roditelji-su-i-te-kako-krivi-sto-ih-deca-obozavaju?fbclid=IwAR2lZWnzJdCE6BhZh3-SNUpeA1wxWsuH79JEmFwBB2rhYyR6QReMmiVTzG>. Shihni gjithashtu Marcello Ravveduto, *La paranza dei bambini*, *La Google Generation di Gomorra*, *Questione Giustizia*, 14 Janar 2017, [https://www.questionegiustizia.it/articolo/la-paranza-dei-bambini-la-google-generation-di-gomorra\\_14-01-2017.php](https://www.questionegiustizia.it/articolo/la-paranza-dei-bambini-la-google-generation-di-gomorra_14-01-2017.php).

# Fishingu në Maqedoninë e Veriut.

Në vitin 2016, Maqedonia e Veriut është bërë famëkeqe kur është zbuluar që faqet e internetit për Trumpin dhe kundër Klintonit kishin prejardhje në një qytet të vogël të Velesit ku shpërndaheshin lajme të rreme nga dhjetëra faqe të ndryshme të internetit gjatë zgjedhjeve presidenciale në SHBA.<sup>1</sup> Që atëherë, duket sikur problemet janë përmbysur, sepse institucionet e Maqedonisë së Veriut dhe bizneset janë bërë viktima të sulmeve kibernetike.<sup>2</sup>

Digjitalizimi ka hapur mundësi të reja, por gjithashtu ka sjellur rreziqe të mëdha. Meqënëse gjithnjë e më shumë njerëz blejnë, përdorin bankën dhe komunikimin online, kriminelët shfrytëzojnë mundësinë e transaksioneve në hapësirën kibernetike për të vjedhur paratë dhe identitetet.<sup>3</sup> Një nga llojet më të përdorura gjërësisht të mashtrimit në internetin njihet zakonisht si 'fishing'.

Fishingu është një teknikë e inxhinierimit social që përdoret për të vjedhur të dhënat apo për të kryer mashtrimin. Bëhet duke dërguar reklama të rrejshme përmes faqeve të rrejshme të internetit për përdoruesit që nuk dyshojnë. Reklamata zakonisht përmbajnë promociione shitjeje për produkte të ndryshme, duke përfshirë, për shembull, pajisjet apo automjetet me çmime joshëse të ulëta. Kjo bëhet për të joshur viktimat e mundshme për të ndarë informacione të ndjeshme (sensitive), siç janë të dhënat personale, emrat e përdoruesve dhe fjalëkalimet, si dhe kartelat pagesore dhe detajet bankare. Rastet e fundit në Maqedoninë e Veriut demonstrtojnë se si këto kriminelë operojnë dhe ndikimi i tyre në kompanitë e vogla dhe të mesme.

Siç tregon shembulli më poshtë, adresa URL në këto fotografi ekrani është e rrejshme: Në vend të 'facebook' në URL, aty shkruan 'fakebook'. Kur përdoruesi zgjedh linkun, kompjuteri i tij apo i saj infektohet me një softuer të dëmshëm, që mundëson që të kontrollohet nga një haker.

Në Maqedoninë e Veriut, një valë e fundit e rasteve të krimit kibernetik thekson rrezikshmërinë. Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme gjithnjë e më shumë po lëvizin online për të tërhequr më shumë klient dhe për të realizuar transaksione nga një kompani në kompani tjetër. Kjo tendencë është përshpejtuar gjatë krizës të COVID-19. Megjithatë, shumë prej këtyre kompanive nuk kanë departamente speciale të TI apo të sigurisë që mund të zvogëlojnë rreziqet e tyre të sigurisë

kibernetike, as nuk paralajmërojnë apo trajnojnë mjaftueshëm stafin e tyre për këto kërcënime.

Qendra Nacionale për Reagim për Incidentet Kompjuterike e Maqedonisë së Veriut raporton se gjatë vitit 2020 – sidomos gjatë shpërthimit të pandemisë – ata kanë detektuar një tendencë në rritje të fushatave të fishing që synojnë përdoruesit, duke përfshirë kompanitë.<sup>4</sup> Mashtrimi në internet në Maqedoninë e Veriut kryesisht lidhet me përgjimin e kundërligjshëm të komunikimit të kompanive përmes porosive elektronike ndërmjet kompanive në vend dhe kompanitë e tyre partnere jashtë shtetit.<sup>5</sup> Kryerësit pretendojnë se përfaqësojnë një kompani të huaj dhe ofrojnë një llogari bankare për pagesën. Në këtë mënyrë, një pagesë legjitime nga kompania në Maqedoninë e Veriut për një partner të huaj të biznesit devijohet në një llogari që kontrollohet nga kriminelët. Keto kriminelë shpesh janë të vështirë të zbulohen, sepse ata shpesh ndryshojnë serverët e përdorur për përgjim të porosive elektronike dhe llogaritë bankare në të cilat janë paguar paratë.<sup>6</sup>

Sipa policisë të Maqedonisë së Veriut, ky lloj i mashtrimit ka shkaktuar dëm prej qindra mijëra eurosh në ekonominë lokale.<sup>7</sup>

Dy raste nga qyteti i Gostivarit ilustron problemin. Në rastin e parë, një haker arriti të depërtonte në sistemin e softuerit të një kompanie në Gostivar duke përgjuar komunikimi me email midis kompanisë dhe partnerëve të saj të biznesit. Në mars të vitit 2016, një burrë nga Republika Çeke ka prezantuar veten një kompanie në Gostivar si pronar i një kompanie në Zvicër. Ai i ka dërguar porosi elektronike pronarit të kompanisë në Gostivar duke bërë disa oferta afariste online. Kompanitë kanë shkëmbyer faturat elektronike dhe kanë komunikuar përmes porosive elektronike në lidhje me pagesën. Kompania nga Maqedonia e Veriut atëherë ka pranuar një porosi elektronike që dukej sikur ishte nga kompania Zvicerane, por që në fakt dërgohej nga një kompani e rrejshme.

Porosia elektronike ka kërkuar pagesën e pjesës të parë të një prej urdhërsave dhe ka ofruar detaje bankare. Kështu kompania nga Maqedonia e Veriut është trukuar dhe ka transferuar në llogarinë e gabuar bankare.<sup>8</sup>

Në rastin e dytë, në vitin 2017 një kompani e mirënjohur import-eksport shmangu viktimizimin nga një mashtrim fishing kur ka zbuluar në minutën e fundit se detajet bankare të dërguara me porosi elektronike për pagesën e €10 000 ishin të ndryshme nga llogaria që është përdorur paraprakisht nga partneri i biznesit.<sup>9</sup>

Një sulm kibernetik jo vetëm që mund të kushtojë shumë për një biznes, por mund të dëmtojë reputacionin e tij. Pronari i një kompanie të mirënjohur në Shkup ka humbur €100 000 kur një haker ka menaxhuar që të përgjojë komunikimin elektronik ndërmjet kompanisë të tij dhe partnerit të biznesit në Serbi.<sup>10</sup> Pronari preferon që të mos e tregojë storjen sepse klientët dhe klientët e mundshëm mund të shmangin të bëjnë biznes me kompaninë që konsiderohet se nuk kujdeset për kontrollat e brendshme apo kanë siguri të dobët. Kompanitë gjithashtu mund të paditen nga klientët të dhënat e të cilëve janë vjedhur përmes sulmeve të hakerëve.

Kompanitë e mëdha nuk janë imune ndaj krimeve kibernetike. Në shkurt të vitit 2020, operatori më i madh celular në vend, Telekom i Maqedonisë, ka raportuar një sulm hakerësh që ka synuar përdoruesit e telefonëve celular në rrjetin T-Mobile. Përdoruesit janë përzgjedhur përmes shkeljes të të dhënave dhe kështu janë kryer sulme pasuese kryesisht përmes hajdutëve kibernetik në Estoni, Lituani dhe Nigeri.<sup>11</sup>

Metodat e hakerëve po bëhen gjithnjë e më të sofistikuar. Në një rast, ata kanë prezantuar veten si 'Forcat policore të Republikës të Maqedonisë' duke përdorur një llogari emaili të rrejshme

(kontakts@moi.gov.mk) për të dërguar porosi elektronike te personat fizik dhe juridik në temën, 'ju jeni ftuar në një hetim aktual për një mashtrim bankar'.<sup>12</sup> Porosia elektronike thoshte: 'Po ju informojmë se jeni të ftuar në Policinë e Republikës të Maqedonisë në lidhje me një hetim aktual për mashtrim bankar. Detajet e ftesës janë përfshirë në dokumentin e bashkangjitur PDF.' Hakerët ishin aq bindës sepse përfshinin logo dhe tekst si ai që përdoret nga përfaqësuesit zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe në dokumentin e bashkangjitur PDF që kanë dërguar. Ky dokument i bashkangjitur lidhet me një skedar të dëmshëm (maluer) (mvr-31720.iso) përmes adresës URL (<https://nyschool.edu.sg/mvr-3170.iso>). Ky skedar i dëmshëm (MSIL/Kryptik.DJ) është zbuluar gjatë hetimit. Nuk dihet sa kompani janë infektuar me këtë softuer të dëmshëm, pra shkalla e demit nuk mund të vlerësohen ende.

Edhe pse krimi kibernetik është në rritje në të gjithë Ballkanin Perëndimor, Maqedonia e Veriut duket sikur është ndikuar në mënyrë joproportionale. Shteti është cituar në raportet e fundit të Qendrës të ankesave dhe krimeve në internet të FBI-së.<sup>13</sup> Në fakt, numri i ankesave për banorët e vendos Maqedoninë e Veriut në vend të dytë në aspekt të krimeve kibernetike, vetëm pas SHBA. Maqedonia e Veriut është vlerësuar e para në aspekt të numrit të krimeve kibernetike në lidhje me numrin e vlerësuar të përdoruesve të internetit.<sup>14</sup>

Incidentet e krimeve kibernetike janë në rritje në Ballkanin Perëndimor, jo vetëm për shkak të rritjes të digjitalizimit të rritur të rajonit dhe tendencës në rritje për shitje me pakicë në internet gjatë krizës të



### Example 1: Customer receive e-mail



Dear customer!

In order to continue our cooperation, we would like to offer you a new collection for the summer of 2020.

On the following link, you can find our new catalog for 2020:

<http://fakebook.com/catalog2020>

Regards

Facebook team!

Foto ekrani nga një reklamë fishingu, Maqedoni e Veriut






FIGURA 5 Fazat tipike në sulmin e fishingut dhe përgjimi i komunikimit me porosi elektronike.

KOVID-19. Klientët dhe bizneset duhet të jenë më të zgjuar, ndërsa ligjzbatuesit dhe sektori privat duhet të rrisin e të kërkojnë bashkëpunimin e tyre. Situata në

Maqedoninë e Veriut kërkon vëmendje të veçantë për përballje me një problem të madh.

## Shënime

- 1 Samanth Subramanian, Brenda kompleksit të lajmeve të rrejshme maqedonase, Wired, 15 Shkurt 2017, <https://www.wired.com/2017/02/veles-macedonia-fake-news/>.
- 2 Bojan Stojkovski, Hakerët ekspozojnë vrimat e hapura në sistemin e TI-së të Maqedonisë, BIRN, 22 Maj 2020, <https://balkaninsight.com/2020/05/22/hackers-expose-gaping-holes-in-north-macedonias-it-systems/>.
- 3 PwC, Luftimi i mashtrimit, Një betejë pa fund, Anketa globale e PwC mbi krimin dhe mashtrimin, 2020, <https://www.pwc.com/fraudsurvey>.
- 4 MKD-CIRT (Agjencia e Komunikimeve Elektronike), Ballina, <https://mkd-cirt.mk/>.
- 5 Kanal 5 TV, Besimi: Do të inkuadrojmë financimin e mençur, 6 Shtator 2020, <https://kanal5.com.mk/besimi-kje-vovedeme-sistem-na-pametni-finansii/a437721>.
- 6 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës të Maqedonisë së Veriut, Raporti për vlerësimin e rrezikut mbi krimin e organizuar dhe serioz (2017–2019), 2019, p. 29.
- 7 Shihni <https://mkprogramer.wordpress.com>.
- 8 Svetlana Nikoloska dhe Marija Gjoseva, E drejta penale, Aspekte kriminologjike dhe kriminalistike të mashtrimit kompjuterik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, *The Great Powers Influence on the Security of Small States*, Ohër, 2019, pp 124–137, <https://fb.uklo.edu.mk/wp-content/uploads/2019/07/2019-tom-2.pdf>.
- 9 Shihni <https://gostivarpress.mk/gostivarski-kompanii-vo-kandhina-internet-izmamnitsi/>.
- 10 Intervistë me pronarin e biznesit që ishte viktimë e sulmit të hakerëve, 18 Shtator 2020.
- 11 Alfa, Паника кај корисниците мобилните мрежи – македонски броеви мета на хакерски напад, Shkurt 2020, <https://alfa.mk/panika-kaj-korisnicite-mobilnite-mrezi-makedonski-broeви-meta-na-hakerski-napad/>.
- 12 Shihni <https://mkd-cirt.mk/2020/07/31/fishing-kampanja-koja-targetira-makedonski-adresi-za-e-poshta-so-lazhno-pretstavuvanje-na-isprajachot-kako-policija-na-republika-makedonija-kontakts-moi-gov-mk/>.
- 13 Qendra e krimeve dhe ankesave në internet (IC3), Raporti i krimit në internet, 2013 [https://pdf.ic3.gov/2013\\_IC3Report.pdf](https://pdf.ic3.gov/2013_IC3Report.pdf).
- 14 Dragi Rashkovski, Vasko Naumovski dhe Goce Naumovski, Tendencat e krimit kibernetik dhe legjislacioni në Republikën e Maqedonisë, *European Journal on Criminal Policy and Research*, 22, 127–151, <https://doi.org/10.1007/s10610-015-9277-7>.

# Krijimi i vizionit të përbashkët, dhe të 'paprekshmit': Rrjeti Ballkanik i Kriminologjisë.

Dr Anna-Maria Getos Kalac, themeluese dhe bashkë-udhëheqëse e Kriminologjisë Ballkanike, dhe profesoreshë e asociuar në Universitetin e Zagrebit, Fakultetin e Drejtësisë, flet për përfundimin e rrjetëve dhe ndarjen e silove ndërmjet akademisë, shoqërisë civile, medias dhe praktikantëve të drejtësisë penale në Ballkanin Perëndimor, dhe për rolin e akademisë në luftimin e korrupsionit.



## **A mund të na tregoni për platformën e Kriminologjisë Ballkanike: pse është e nevojshme dhe çfarë bën?**

Kur unë përfundova studimet e doktoraturës (PhD) në Institutin Max Planck për studimin e krimit, sigurisë dhe drejtësisë (në Frajburg, Gjermani), unë kërkova diçka të ngjajshme në Ballkan. Por shumica e instituteve të mëdha të kriminologjisë në ish Jugosllavi nuk ishin më aktive. Prandaj u përpoqa që të lidhem me kolegë që kishin mendime të ngjajshme në Europën Juglindore – njerëz në fushën time për të ndarë ide dhe për të punuar me ato. Gjithashtu e kuptova se meqë krimi i organizuar është transnacional, për ta studiuar atë nevojitet një përgjigje transnacionale në komunitetin e hulumtimit. Reth dhjetë vite më parë, unë fillova të kërkoj të paktën një kontakt domethënës në çdo shtet Ballkanik. Dhe kështu ka filluar Kriminologjia Ballkanike, si një rrjet i hulumtuesve të rinj.

Në bëmë projekte bashkë, si hartëzimi i krimit të organizuar në rajon, duke parë viktimologjinë dhe hetimin e situatës në burgje. Ne takoheshim sa herë që ishte e mundur për konferenca, punëtori dhe seminare. Mendoj që ka ndihmuar se kishim mendime të ndryshme nga gjeneratat e vjetra: nuk ishim shumë të interesuar në historinë e fundit të rajonit apo në çështjet që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike. Ne jemi grumbulluar bashkë si hulumtues, akademikë, prokurorë publike, nga njerëz nga shoqëria civile që dëshirojnë të mësojnë njëri nga tjetri.

## **Si e sqaroni faktin, apo të paktën perceptimin, që ka një incidencë të lartë të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor, por pothuajse asnjë hulumtim rreth tij nuk buron nga rajoni?**

Në akademi ka një fokus të fuqishëm mbi botimin. Shumë nga revistat e respektuara ndërkombëtare të kriminologjisë janë të botuara në anglisht. Ky është një hendikep për personat nga Ballkani Perëndimor të cilët nuk shkruajnë mirë në anglisht apo nuk mund të përballojnë një redaktor. Prandaj, edhe nëse disa ekspertë të kriminologjisë nga rajoni kanë të dhëna të mira, ata rrallëherë kanë mundësinë për të publikuar ato. Hulumtuesit që janë jashtë rajonit përpiqen që të publikojnë, por shpeshherë pa njohurinë e tyre empirike apo një të kuptuar të mirë të situatës lokale. Ndërmjet janë OJQ-të: ata janë rrallëherë kriminolog dhe nuk respektojnë të njëjtat standarde të botimit si edhe akademikët. Por ata njohin rajonin, kanë mundësi që të publikojnë brenda rajonit dhe kanë resurse të mjaftueshme meqënëse ata mund të marrin para nga donatorët. Ata nuk mbështeten vetëm në financimin publik, si universitetet.

## **Dikush njëherë ka përshkruar kriminelët nga Ballkani Perëndimor se ende operojnë në 'Jugosferë'. Kur analizojmë krimin e organizuar, a e konsideroni Ballkanin si një hapësirë të vetme kriminologjike?**

Absolutisht. Rajoni është një hapësirë kriminale sui generis, ku shtetet rajonit kanë histori të ngajshme, korniza ligjore dhe tregje kriminale. Sigurisht që ka faktorë të përbashkët që dallojnë rajonin nga perspektiva sociologjike dhe kriminologjike. Fatkeqësisht, për këtë arsye nocioni "Ballkani" shpesh përdoret në mënyrë peorative.

### **Cilat janë sfidat në sjelljen e njerëzve nga shtetet dhe disiplinat e ndryshme të cilët studiojnë dhe analizojnë krimin e organizuar në Ballkanin Perëndimor?**

Sfida kryesore për të sjellur bashkë një rrezit nga rajoni është mungesa e resurseve. Pothuajse nuk ka pengesa tjere. Edhe pse ka relativisht pak gazetarë akademikë hulumtues dhe njerëz nga shoqëria civile në rajon të cilët janë fokusuar në krimin e organizuar dhe korrupsionin, ata takohen rrallëherë. Prandaj, çdo vit që nga vitit 2014 – duke falënderuar Institutin Max Planck dhe tani Fondin e resistencës GI-TOC – Kriminologjia Ballkanike ka organizuar një kurs një javor në Dubrovnik mbi hulumtimin e krimin në Ballkan. Në Ballkan, ka një traditë të fuqishme të njerëzve që mbështeten në kontaktet dhe rrjetat personale. E njëjta qasje duhet të zbatohet edhe për hulumtuesit që punojnë në krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kjo është arsyeja se pse ky takim vjetor është aq i rëndësishëm: për të ndarë silot, të bëhen kontakte të reja, të mësohet nga njëri tjetri dhe të takohemi joformalisht.

### **A mund të na tregoni disa prej sfidave me të cilat jeni përballur në Kroaci në aspekt të financimit publik të hulumtimeve.**

Korrupsioni dhe lidhjet që diktojnë shumë atë se si funksionojnë gjërat në rajonin tonë, gjithashtu ndikojnë

në atë nëse projekti juaj merr financim publik. Ne gjithashtu hasim në vështirësi në aplikimin dhe administrimin e granteve të hulumtimit nga jashtë vendit. Në shumë raste, proceset janë më të vështira nga ajo që mund të përballojnë resurset tona të kufizuara njerëzor.

### **Si do ta karakterizonit situatën e krimin të organizuar në Ballkanin Perëndimor?**

Tregjet apo grupet kriminale në Ballkanin Perëndimor nuk janë më domethënëse se ata në pjesën tjetër të botës.

Problemi më i madh këtu është ndikimi i krimin të organizuar mbi shtetin. Ka afaristë kryesorë të cilët kanë lidhje me politikanët dhe zyrtarë në sektorin e sigurisë.

Këta njerëz kanë ndikim dhe fuqi – unë i quaj ata 'të parprekshmit'. Ky lloj i krimin të organizuar është kërcënim më i madh për stabilitetin dhe qeverisjen në Ballkan.

### **Çfarë bëni që më shumë hulumtues të rinj në Ballkanin Perëndimor të interesohen në studimin e krimin të organizuar? Dhe si mund të ndihmojë arsimit për të dhënë një kulturë të ligjshmërisë dhe integritet?**

Është thelbësore që të zhvillohet një gjeneratë e re e hulumtuesve dhe të sillen ata bashkë përmes një platforme si Kriminologjia Ballkanike. Neve gjithashtu na nevojiten më shumë kontakte ndër-disiplinore dhe projekte të përbashkëta. Sa i përket mësimdhënies të kulturës të ligjshmërisë, unë mendoj se ju mund të bëni ndryshim në nivel të universitetit, për shembull në fakultetin e drejtësisë. Por nuk kam iluzione: ka kufij të asaj që ne mund të bëjmë nëse i tërë sistemi është i korruptuar.

Rrjeti ballkanik i Kriminologjisë, i themeluar në vitin 2013, është krijuar për të ndërtuar rezistencë ndaj krimin të organizuar dhe kapjes kriminale të shtetit në Evropën Juglindore. I mbështetur nga Fondi i resistencës GI-TOC,

rrjeti sjell bashkë akademikët, gazetarët, profesionistët e drejtësisë penale dhe OJQ-të të angazhuar në luftën kundër krimin të organizuar në Ballkan.

# Mirënjohe

Ky Buletin i rrezikut është rezultat i Iniciativës globale të shoqërisë civile kundër krimit të organizuar transnacional për luftimin e krimit të organizuar në Europën Juglindore (Obs-EJL).

Obs-EJL është një platformë që lidh dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Ka për qëllim t'i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe mapojë tendenca kriminale, dhe ndikimin e tyre në flukset e kundërligjshme, qeverisjen, zhvillimin,

marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe sundimin e ligjit. Obs-EJL mbështet shoqërinë civile në monitorimin e tyre të dinamikës nacionale dhe trendet më të gjëra rajonale dhe ndërkombëtare të krimit të organizuar. Obs-EJL është filluar si rezultat i Samitit të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në vitin 2018 në Londër, që është pjesë e Procesit të Berlinit.

Ne do të dëshirojmë të falemnderojmë Safet Mushiç dhe Ivica Simonovski për kontributet e tyre të vlefshme.

Buletinët e rrezikut janë produkte të rregullta të observatorëve tanë rajonal, të cilët mbështeten në rrjetet e shoqërisë civile për të ofruar të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar trendet që lidhen me rrjetet e krimit të organizuar, tregtinë e kundërligjshme dhe përgjigjet e shtetit për ta. Nëse dëshironi të regjistroheni për botimet e ardhshme të Buletinit të Rrezikut, ju lutemi regjistroheni këtu ose dërgoni një email te [almedina.dodic@globalinitiative.net](mailto:almedina.dodic@globalinitiative.net).

### **MBI "INCIATIVËN GLOBALE"**

Iniciativa globale kundër krimit të organizuar transnacional është një rrjet global me 600 ekspert të rrjetit rreth botës. Iniciativa globale ofron një platformë për të promovuar një debat më të madh dhe qasje inovative si blloqe ndërtuese për një strategji globale përfshirëse kundër krimit të organizuar.

**[www.globalinitiative.net](http://www.globalinitiative.net)**

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit për konflikt, stabilitet dhe siguri të Mbretërisë të Bashkuar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e GI-TOC dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e Mbretërisë të Bashkuar.



**GLOBAL  
INITIATIVE**  
AGAINST TRANSNATIONAL  
ORGANIZED CRIME